



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1782/3 prot.

Gramsh, më 07/08 /2021

VENDIM

Nr.99, datë 31/08/2021

“PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.95, DATË 28.12.2020 “PËR MIRATIMIN E NUMRIT MAKSIMAL DHE NIVELIT TË PAGAVE E TË SHPËRBLIMEVE TË PUNONJËSVE E PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR TË BASHKISË GRAMSH DHE NJËSIVE VARTËSE TË SAJ, PËR VITIN 2021”

Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës 31/08/2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe P/Vendimin “Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur e të emëruar, të Bashkisë Gramsh, për vitin 2021” të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, bazuar në Ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 54 pika “ç” dhe “dh”; Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës” i Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar); Kodi i Procedurave Administrative të RSH; VKM Nr.177, datë 08.03.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.165, datë 02.03.2016 të Këshillit të Ministrave “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të vetëqeverisjes vendore”; VKM nr.1149, datë 24.12.2020 "Për disa ndryshime në Vendimin nr.175, datë 08.03.2017 të Këshillit të Ministrave, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë, të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në arsimin parauniversitar" të ndryshuar", Vendimin nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimeve në nivelin e pagave për punonjësit mësimor dhe jomësimor në Konviktin e Shkollës së Mesme dhe Çerdhen e Qytetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, miratuar me Vendimin nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit, tabela nr.II;


2. Miratimin e nivelit të ri të pagave për punonjësit mësimor dhe jomësimor në Konviktin e Shkollës së Mesme dhe Çerdhen e Qytetit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit, sipas tabelës bashkëlidhur P/Vendimit;
3. Me anë të këtij Vendimi shfuqizohet çdo pikë tjetër e Vendimit nr.95, datë 28.12.2020 "Për miratimin e numrit maksimal dhe nivelit të pagave e të shpërblimeve të punonjësve e personave të tjerë, të zgjedhur dhe të emëruar, të Bashkisë Gramsh për vitin 2021" të këshillit, që bie në kundërshtim me këtë vendim;
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

Tabela përmbledhëse e pagave është pjesë e këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 10(dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sekretari i Keshillit

Xhulia Gjini



Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: --/
Konfirmoi: --/
Afati i ruajtës: RHK

Kryetari i Këshillit





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 1782/14 prot.

Gramsh, më 07/09/2021

**STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE NIVELI I PAGAVE PËR ADMINISTRATËN E
NJËSITË VARTËSE TË BASHKISË GRAMSH PËR VITIN 2021:**

II-Struktura organizative dhe niveli i pagave për Njësitë vartëse të Bashkisë Gramsh (viti 2021).

4 DREJTORIA E ARSIMIT, KULTURËS DHE SPORTIT (1+8+9+3+8+2+7+73+36)							
Konvikti i shkollës së mesme (1+7)							
4.18	Përgjegjëse konvikti	Lartë	1	K.Punë	Vkm nr.177, II-b, L.5	49000	PG+(PGX2%)+SHP
4.19	Kujdestare	Lartë	1	-//-	Vkm nr.177, III-a/1, L.5	42200	PG+(PGX2%)+SHP
4.21	magaziniere	-	1	-//-	Vkm nr.177, p.19	35000	(1%X30000)+35000
4.23	sanitare/rrobalarese roje civile	-	3	-//-	Vkm nr.177, p.19	35000	(1%X30000)+35000
Çerdhja e qytetit (1+6)							
4.25	Përgjegjëse e Çerdhës	Lartë	1	K.Punë	Vkm nr.177, III-a/1, L.5	45200	PG+(PGX2%)+SHP
4.26	Edukatore Çerdhe	Lartë Mesëm	4	-//-	Vkm nr.177, III-a/1, L.5	45000 39000	PG+(PGX2%)+SHP (1%X30000)+39000
4.27	Kuzhinierë çerdhës	Prof.	1	-//-	Vkm nr.177, p.19	35000	(1%X30000)+35000
4.28	Sanitare çerdhës	-	1	-//-	Vkm nr.177, p.19	35000	(1%X30000)+35000

Sekretari i Këshillit

Kryetari i Këshillit

Xhulia Gjini

Greta LENA

Konceptoi: Xh. Gjini
Pranoi: G. Lena
Miratoi: -//-
Konfirmoi: -//-
Afati i ruajtjes: RHK